



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA**

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

**MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE**

Në përputhje me nenin 1 pika 1.3 paragrafi (ç) pika 1.7. paragrafi (d) të Rregullores 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohëshme të Vetëqeverisjes në Kosovë. Duke patur parasysh fushëveprimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale përkitazi me politikat e veprimit për mbrojtjen e familjeve dhe të miturëve. Me qëllim të rregullimit dhe avansimit të pozitës së femive të braktisur nga prindërit legjitim, **Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:**

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR .16/2004
PËR
RREGULLIMIN E STREHIMIT FAMILJAR NË KOSOVË**

Neni 1

Qellimi i Udhëzimit Administrativ

1.1 Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim që në menyrë unike dhe standarde të rregulloj vendosjen e femijëve në strehim familjar, atëherë kur qendrimi i fëmiut në familjen e tijë është i pamundur, si dhe të rregulloj procedurat përkatëse të cilat janë të nevojshme për strehim familjar të fëmiut.

Neni 2

Strehimi Familjar

2.1 Strehimi familjar është vendosja e femiut të braktisur, pa prind, pa kujdes prindror i rrezikuar pa vend strehim në familjen strehuese.

Neni 3

Kushtet e përgjithshme për strehim familjar

3.1 Me rastin e strehimit familjar, femiut të strehuar, patjeter duhet ti mundësohet një zhvillim normal në rrethin e ri familjar.

3.2 Strehimi familjar i fëmiut mund të bëhet vetëm atëherë kur nga familja strehuese i plotësohen nevojat e përgjithshme, siq janë: ushqimi, strehimi, veshmbathja, dashuria prindore, lidhja emocionale, lojrat, edukimi, kujdesi shëndetësor, zhvillimi i identitetit si dhe të gjitha nevojat e tjera të pranuar me konventat nderkombëtare për të drejtat e femiut.

Neni 4

Përmbushja e kushteve dhe kriterëve të femiut për strehim familjar

4.1 Për tu vendosur fëmiu në strehim familjar, duhet plotësuar këto kushte dhe kriterë:

- Të jetë i braktisur prej lindjes nga prinderit e tij natyror, apo nga kujdesi prindror,
- Ti kenë vdekur prinderit,
- Të jetë i larguar nga familja,
- Të jetë i keqtrajtuar, rrezikuar apo i abuzuar nga prindërit,
- Të ketë qenë i vendosur nën përkujdesje rezidenciale,
- Ti ketë prinderit në vuajtjen e denimit-paraburgim ose burgim,

Neni 5

Kriteret e strehimit familjar për familjet strehuese

5.1 Për ta bërë strehimin familjar të fëmiut, familja strehuese duhet të plotësojë këto kriterë :

a. Strehuesi familjar duhet të jetë mbi moshën 25 vjeçare,

- b.** Familja strehuese duhet të ofroj kujdes të plotë për tërë periudhën e strehimit familjar, goftë në afat të shkurtër apo për vendosje afatëgjate të femiut.

- c.** Fëmijët e familjes strehuese, duhet të jenë mbi moshën (2) dyvjeqare në rastet kur fëmiu i strehuar është nën moshën 2 vjeqare.

- d.** Strehuesit familjar në ç’do kohë dhe moment duhet të tregojnë gadishmerinë e tyre për bashkpunimin me prindërit natyror të fëmiut për reintegrimin e fëmiut në familjen e tij biologjike,

- e.** Strehuesit familjar nuk duhet të jenë të përndjekur penalisht për ndonjë veper penale,

- f.** Strehuesit familjar në kontinuitet duhet të jenë të gatshëm të punojnë në partneritet me Qendrat për Punë Sociale dhe shërbimet tjera të cilat punojnë për avancimin e pozitës së fëmijëve,

- g.** Strehuesit familjar nuk duhet të jenë të punësuar në QPS,OJQ vendore ose ndërkombëtare të cilat ofrojnë shërbime të kujdesit familjar.

Neni 6

Pagesat për strehim familjar

- 6.1** Familjet strehuese për strehim familjar të fëmiut kanë të drejtë në kompenzim financiar mujor, në shumën prej 90 €për ç’do fëmijë të strehuar.

- 6.2** Për muajin e parë të strehimit të fëmiut, strehuesit familjar i takojnë edhe 75 €si ndihmë e veqantë, në emër të përgaditjeve për strehim familjar.

- 6.3** Mvarsisht nga mundësitë bugjetore dhe rrethanat e tjera vlere e pagesave mujore mund të ndryshojë me vendimin e Departamentit të Mirëqenies Sociale të MPMS.

- 6.4** Për femijet të cilet janë gjithashtu pa kujdes prindëror dhe të cilet janë pa mjete për ekzistencë, nën kujdestari apo të strehuar te të afërmit e tyre, MPMS mund të ju ofroj mdihmë financiare mujore, varsishtë nga mundësitë buxhetore, por pa marrë obligime kontraktuese për pagesa të rregullta mujore.

Neni 7

Institucionet përgjegjëse për strehim familjar

- 7.1** Divizioni i Shërbimeve Sociale që vepron në kuadër të Departamentit të Mirëqenies Sociale të MPMS, është përgjegjës për realizimin dhe mbikqyrjen e politikave të programit të përgjithshëm të strehimit familjar në Kosovë.
- 7.2** Qendrat për Punë Sociale, të cilat veprojnë në kuadër të MPMS janë përgjegjëse për zbatimin konkret të programit të përgjithshëm për strehim familjar, nga pranimi i kërkesave për strehim familjar deri te vendosja e fëmiut në familjen strehuese si dhe për vlerësimin, monitorimin dhe vëzhgimin e pozitës së fëmiut të strehuar dhe ofrimin e përkrahjes së vazhdueshme për familjet strehuese.

Neni 8

Hyrja ne fuqi

- 8.1** Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi, në ditën e nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

**Ministri i MPMS-së
Ahmet Isufi**

Prishtinë, Tetor 2004

Neni 1

Neni 6 paragrafi 6.1 ndryshohet